



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300729/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda :** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë.*

**Drejtuar:** **Z. Kreshnik GJEÇKA**  
**Shef i Komisariatit të Policisë Nr. 7**

**VORË**

**Për dijeni:** **Z. Tonin VOCAJ**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisariatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë më datë 30.08.2023.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr.81 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" kreu inspektimin sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim.

### **Shënime paraprake**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit<sup>1</sup> në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e Komisarariatit z. Kreshnik Gjeçka dhe zëvendës shefin e Komisarariatit z. Eltion Shaholli të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, stafi i punës komisarariatit informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit vitin e kaluar, në lidhje me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati, sipas kritereve të përcaktuara në procedurat standarde.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësit e policisë që shërbenin në zyrën e informacionit dhe në dhomat e shoqërimit. Theksojmë se, punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi inspektues në ambientet e këtij Komisaritati.

Grupi i inspektimit, në vijim inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, nga inspektimi i mëparshëm<sup>2</sup>, rezultoi se:

Konkretisht, grupi inspektimit konstatoi se ishin zbatuar rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me:

---

<sup>1</sup> Inspektimet e Avokatit të Popullit nuk janë inspektime të lajmëruara më parë.

<sup>2</sup> Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/26-2 prot., datë 15.03.2019.

- **Ishte plotësuar rekomandimi** për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin dhe në dhomat e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Vorë.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi** për marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e ngrohjes në dhomat e shoqërimit të këtij Komisarlati.

Rekomandimi pararendës i Avokatit të Popullit është pranuar nga Komisarlati i Policisë Vorë<sup>3</sup>, megjithatë vërejmë se të dyja rekomandimet e pazbatuara ende kërkojnë fonde buxhetore, për të cilat u informuam se nuk ishin bërë kërkesat përkatëse nga drejtuesit e Komisarlatit. Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë ambienti i shoqërimit në përgjithësi ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të institucionit dhe përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete 1(një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

<sup>3</sup> Shkresa nr. 607/1 prot., datë 26.04.2019 “Kthim përgjigje” e Komisarlatit të Policisë Vorë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dritaret e këtyre mjediseve ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise, por vlerësojmë që këto dritare duhet të jenë të siguruara me një zgarë më të imët në mënyrë që të mos lënë hapësira për vetëdëmtimin e personave të shoqëruar gjatë qëndrimit në këto ambiente. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra, nga ana higjieno-sanitare. Dhomat e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje/ftohje.

Në korridorin e godinës, afër ambientit të shoqërimit, kishte dy tualete, një për gratë dhe një për burrat, të cilët përdorshin nga të shoqëruarit.

Në këtë Komisariat ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit.

Në Komisaratin e Policisë Nr. 7 në Tiranë, gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 30.08.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **188** persona. Gjatë verifikimeve të regjistrave për periudhën e cituar me lart ishin shoqëruar 7 shtetase gra dhe 6 shtetas të mitur në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. Mekanizmi Kombëtar **vlerëson praktikën për dhënien e kopjes së kartës së të drejtave në momentin e hyrjes në komisariat**, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre, të garantuara nga ligji.

Gjatë inspektimit u këqyren të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e Komisarariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe personave të ndaluar/arrestuar, të cilat ishin të aksesueshme nga këta persona.

Në Komisarlatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, në mungesë të saj oficerët e policisë gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre të cilat shërbejnë edhe për intervistimin e personave të shoqëruar/ndaluar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e ndaluar/arrestuar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Bllokut të Sigurisë Tiranë.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Nr. 7 në Tiranë, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i ri sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Ndërkohë, **përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatuam se rubrika e regjistrimit mbi njoftimin e familjarëve nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte**, pasi evidentuam në regjistër shumë raste ku këto rubrika ishin të paplotësuara duke bërë të pamundur identifikimin e familjarit i cili ka marrë dijeni<sup>4</sup>, kjo bazuar në Urdhrin, nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit e përcaktuar në “*Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit ” ku në pikën a.1.4 gërma “k” citohet se: Për personat e shoqëruar, evidentohen të dhënat e mëposhtme: Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmye për shoqërimit si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit.*”

---

<sup>4</sup> Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit të një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.

Në këtë Komisariat mbahej regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre për organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat **nuk kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave** të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisariat e Policisë Nr. 7 në Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare<sup>5</sup>, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit. Ky standard ka gjetur rregullim edhe në procedurën standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, duke u shndërruar në rregull të detyruar për punonjësit e policisë.

Theksojmë se vijon të mbetet shqetësuese ndjekja e praktikës së marrjes në pyetje të të shoqëruarve në zyrën e punës së specialistit/oficerit të policisë gjyqësore në Komisariat e Policisë nr. 7 në Tiranë. Një praktikë e tillë bie ndesh edhe me Urdhrin

---

<sup>5</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

Konsulto:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>

e mësipërm të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, i cili në Kreun VII pika 5 parashikon se “Rregullat e sigurisë gjatë marrjes në pyetje/intervistim dhe takimeve të ndryshme me të arrestuarin/ndaluarin” parashikon veçanërisht kryerjen e kësaj procedure në një ambient të posaçëm siç është dhoma e intervistimit/marrjes në pyetje.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, përfaqësuesit ligjor dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ose në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Vorë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Aktit të procedurave standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit” për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse<sup>6</sup>.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga

---

<sup>6</sup> Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

2. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e dritareve me një zgarë më të imët për të evituar vetëdëmtimin e personave të shoqëruar gjatë qëndrimit në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë Nr. 7 në Tiranë.
3. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e ngrohjes në dhomat e shoqërimit të këtij Komisarati.
4. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi të rubrikës “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmve*” tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre në këtë regjister sipas kërkesave të parashikuara në procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një regjister për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarati.
6. Marrjen e masave për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**

Konc. & Dakord.:  
G. Çarkaxhiu  
N.Qafzezi